



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1062/2 Prot.

Vlorë, më 18.08.2017

Vendim
Nr. 24, datë 18.08.2017

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR MARRJEN ME QERA TË HARDWERËVE
PËR HOSTIM SERVETRI TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Bazuar në nenet 3, pika 3d, 49/a të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës e 18.08.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë të fondit për marrjen me qera të hardware-ve për hostim serveri që janë të nevojshme për Drejtorinë e IT për kontrollin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e faqes WEB www.univlora.edu.al të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Efektet financiare të përballohen nga fondi hostim serveri në buxhetin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Bashkangjitur këtij vendimi vendoset një kopje e shkresës me nr. 1062 Prot, datë 18.08.2017 së bashku me relacionin përkatës të administratorit, vendimi i Senatit Akademik nr. 67, datë 13.06.2017, relacioni i Drejtorisë së IT, datë 14.06.2017, relacioni i Drejtorisë së IT, datë 14.08.2017..

1. Rezana Vrapit – Kryetar
2. Florian Nurçe – anëtar
3. Enida Pulaj – anëtar
4. Eduard Ahmeti – anëtar
5. Elsjed Rexhaj – anëtar
6. Marinela Muço - anëtar

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr 1062 Prot

Vlorë, më 18 .08.2017

Lënda : Kërkesë

Drejtuar: Znj Rezana Vrapì
Kryetare Bordit të Administrimit

E nderuar Znj Kryetare

Në zbatim të Vendimit të Senatit Nr 67 Prot datë 13 .06 .2017,më lejoni që me anë të kësaj shkrese t'ju paraqesë kërkesën për miratim fondi,për marrjen me qera të hardëereve,për hostim serveri ,që janë të nevojshme për Drejtorinë e IT ,për kontrollin,mirëmbajtjen dhe menaxhimin e faqes së ëeb-it ëëë.univlora.edu.al të Universitetit.

Bashkalidhur kërkesës ;

1. Relacion Administrator
2. Vendimi Senatit Nr 67 prot datë 13 .06.2017
3. Relacioni Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave datë 14.06.2017
4. Relacioni Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave datë 14.08.2017

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

ADMINISTRATOR
Mirela DUKA

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

RELACION

Mbi miratim fondi për marrjen me qira të serverit për hostimin e faqes ëeb
www.univlora.edu.al dhe ndryshime në Rregjistrin e Prokurimeve Publike
për vitin 2017

Aktualisht faqja e web-it www.univlora.edu.al menaxhohet dhe kontrollohet nga shoqëria FASTECH e Tiranës me web www.fastech.com.al, e cila këtë shërbim e ka nën kontraktuar te Shoqëria Abcom me web www.abcom.al. Nënkontraktimi faqes ka sjellë vështirësi të vazhdueshme në menaxhimin e faqes për Drejtorinë e IT-së.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2017 është parashikuar shërbim Hostimi në vlerën 600.000 lekë në vit

Duke u bazuar ne relacionet e Drejtorisë së IT-së ,datë 14.06.2017 ,paraqitur ne Senatin Akademik dhe relacionin nr 1057 prot e datës 14.08.2017 drejtuar Administratores së Universitetit ,në lidhje me domosdoshmërinë e menaxhimit dhe kontrollit të faqes web nga Drejtoria e IT-së dhe ndërprerjen e hostimit te subjektet e treta,propozoj :

- Variantin e marrjes me qera të paisjeve për hostimin e faqes ëeb www.univlora.edu.al me kosto 1000 euro(133,000 njeqind e tridhjetee tremije lekë). ne vit.

NR	PRODUKTI	SASIA	ÇMIMI /EURO	VLERA/EURO
1	Server Ëeb-i Versioni Cloud	1		
2	Softëare Çertifikata sigurie	+	1	
TOTALI				1000 euro ne vit

Varianti i marrjes me qera i paisjeve për Hostimin e faqes web www.univlora.edu.al ka disa avantazhe:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

- Redukton shërbimin e hostimit nga 600.000 (gjashtëqind mijë)lekë në 133,000 (njëqind e tridhjetee tremije)lekë.
- Realizohet kontrolli i plotë i ËEB-it nga UV
- Nuk do të ketë shpërndarje dhe rrjedhje të informacioneve sensitive ,të dhëna personale,nga brenda serverit tek palë të treta
- Realizohet shërbim i menjëhershëm dhe jo i porositur dhe i pritur
- Kryhet në çdo rast e kohë ,transparencë në shërbim dhe kërkesë e sigurt llogarie

Ndryshimet e mësipërme në rregjistrin e parashikimeve publike do të paraqiteshin si me poshtë vijon:


Nr	Objekti Prokurimit	Ishte	Behet	Procedura	Periudha
11	HOSTIMI serveri	600.000	0	Blerje e vogël	Korrik
11	Marrje me qera hardëare për hostim faqe web-i	0	133,000	Blerje e vogël	Gusht/Shtator

ADMINSITRATOR

Mirela DUKA



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK



Nr. Prot.

Vlorë, më 13.06.2017

Vendim
Nr. 67, datë 13.06.2017


PËR BLERJEN E SERVERIT DHE AKSESORËVE TË TJERË NË FUNKSION
TË WEB-it TË UV-së DHE MARRJEN NËN KONTROLL (DOMAIN DHE
HOSTING) TË TIJ NGA DREJTORIA E IT-së DHE STATISTIKAVE

Në mbështetje të shkronjës *d*, pika 3 në nenin 3 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2017

VENDOSI:

1. Në përfundim të kontratës së lidhur mes UV-së dhe kompanisë "Fastech", *domain*-i dhe shërbimi *hosting* i WEB-it të institucionit të kalojë nën kontroll të plotë të Drejtorisë së IT-së dhe Statistikave.
2. Për një Web bashkëkohor dhe modern, i cili i shërben qëllimeve të institucionit, brenda muajit korrik, të blihen serveri dhe aksesorët përkatës: inverter > 3.5 KW, bateri 100 Ah (Gel), UPS > 3.5 KW, software + certifikata sigurie, në funksion të pavarësisë së plotë nga kompani kontraktore e nënkontraktore.
3. Vendimi t'i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria Juridike, Drejtoria e IT dhe Statistikave si dhe Drejtoria e Prokurimeve dhe Shërbimeve.
5. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI



Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

Nr. Prot.

Vlorë, më 12.06.2017

Lënda : Relacion shpjegues për web-in zyrtar www.univlora.edu.al të UV-së dhe për nevojën e kalimit në kontroll (Hosting dhe Domain) të Institucionit.

Drejtuar : Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë,
Prof. Dr. Roland Zisi
Senatit të UV-së.

Faqja zyrtare është hapur për herë të parë në mënyrë funksionale nga Ervin Ruci (Spec. IT) dhe Rezart Muço (Spec. IT) gjatë vitit 2009, në kohën që universiteti drejtohej nga Prof. Dr. Tanush Shaska. Domain name blihej nepermjet ketyre procedurave ne AKEP (Autoriteti i komunikimeve dhe elektronike dhe postare. Kjo faqe është hostuar në "lunarpages.com" domethënë host i tretë që paguhej nga ana e IT me kartë krediti dhe më pas universiteti gjente mënyrën për ta rimbursuar.

Në vitin 2010 kjo faqe u mbyll për disa kohë dhe u rihap sërish në janar 2011 ku u bë kërkesë për një dizenzim grafik nga një kompani grafike në Tiranë dhe ky dizenzim grafik u shndërrua në wordpress template custom build nga Altin Mahilaj (Spec. IT). Më pas faqja ridizenjohet nga Altin Mahilaj (Spec. IT) dhe Arjan Bilu (Spec. IT) duke vendosur një template, "Nderfaqe" të re.

Vlen të theksohet fakti se në vazhdim nderfaqja është ndryshuar edhe dy herë të tjera nga Fjodor Ziu (Laborant) i cili e ka rinovuar por gjatë kësaj kohe që i bie afërsisht 3 vite nga momenti i tanishëm hostimi i faqes bëhet subjekt tenderi dhe tenderohet ku fitues del Kompania Fastech nga Tirana me web: www.fastech.com.al/e cila e ka fituar tenderin edhe për 2 vitet e tjera në vazhdim që përfundon diku në gusht të 2017 të këtij viti.

Tenderi është në vlerën e 500.000 mijë lekë të reja në vit. Kjo kompani nga ana e saj hostimin e faqes univlora.edu.al ja ka lënë për detyrë një nënkontraktuesi të tretë konkretisht abcom.al e cila përdor servera që fizikisht ndodhen në Tiranë. Momentalisht edhe një ndërfaqe tjetër është e gatshme por që nuk është vënë në punë dhe mbahet në rezervë që të përdoret në një moment të përshtatshëm dhe e disponon IT.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

Pra infrastruktura ku hostohet WEB-i i UV-së nuk kontrollohet nga IT e institucionit por nga kompani dhe specialistë jashtë institucionit. Që faqja elektronike të merret në kontroll nga vetë institucioni duhet të sigurohen paraprakisht infrastruktura e nevojshme teknike.

Pengesë për marrjen në kontroll të webfaqes univlora.edu.al dhe hostimin e saj nga vet IT bëhet mungesa e infrastrukturës për këtë qëllim. Me fjalë të tjera duhen blerë server dhe pajisjet ndihmëse të tyre (aksesor) të cilët fizikisht duhet të ndodhen në ambientet e Universitetit "Ismail Qemali".

Për të arritur këtë qëllim propozohen të bëhen blerje fizike si më poshtë:

Nr.	Produkti	Sasia	Çmimi/Euro	Vlera/Euro
1	Server Web-i	1	7000	7000
2	Inverter > 3.5 KW	1	2000	2000
3	Bateri 100Ah (Gel)	4	200	800
4	UPS > 3.5 KW	1	3000	3000
5	Software + Certifikata Sigurie	1	1000	1000
6	Sherbim Interneti (ISP te dyte)	1 vit	Opsional	200
7	Firewall device	1	Opsional	2000
Totali			13800	(17000 Opsional)

Këto pajisje do të qëndrojnë në një ambient të përshtashëm brenda Universitetit tonë ku do të mirëmbahen dhe përditësohen nga punonjësit e IT të cilët do të kenë edhe detyrën dhe përgjegjësinë e ruajtjes.

Me blerjen e këtyre pajisjeve bëhet e mundur që webfaqja jonë të kaloj plotësisht në kontrollin e IT dhe të përdoret gjerësisht edhe për nevoja të tjera të Universitetit tonë. Theksojmë se vlera e përafërt, sipas ofertave të tregut, e Serverit dhe aksesoreve të tjerë që mundësojnë pavarësimin e plotë dhe kontrollin tërësor institucional mbi WEB-in e UV-së, nuk e kalon shifrën 14 mijë euro.

Nëse bëhet ky investim themelor atëherë do të kemi një situatë tjetër me disa përfitime dhe avantazhe, si më poshtë:

1. Nuk do të kemi shpërndarje dhe rrjedhje të informacioneve, të dhëna personale, nga brenda serverit tek palë të treta.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

2. UV nuk do të prokurojë çdo vit shërbimin për WEB-in që kushton 500.000 mijë lekë të reja.
3. UV mund ta përdor këtë investim edhe për nevoja dhe qellime të tjera të brendshme të cilat janë në rritje.
4. UV mund të gjeneroj fitime nëpërmjet këtij investimi duke e përdorur atë me pagesë kundrejt palëve të treta të interesuara për të hostuar webfaqe dhe shërbime të ngjashme.
5. UV nuk do të jetë i varur dhe i ndërvarur nga kompani kontraktore dhe nënkontraktore.
6. Investimi i kryer një herë të vetme mbetet në pronësi të UV-së.
7. Realizohet kontrolli i plotë dhe i drejtpërdrejtë i WEB-it nga institucioni.
8. Realizohet shërbim i menjëhershëm dhe jo i porositur dhe i pritur.
9. Kryhet në çdo rast e kohë, transparencë në shërbim dhe kërkesë e sigurt llogarie.
10. WEB-i i UV-së kthehet në një strukturë multimediale në shërbim dhe pronësi të plotë të institucionit.

Ing. Medrit MUSTAFARAJ, Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave

Altin Mahilaj, specialist

Fjodor Ziu, laborant



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

Nr. 1057 Prot.

Vlorë, më 14.08.2017

Lënda: Relacion shpjegues për web-in zyrtar www.univlora.edu.al të UV-së dhe për nevojën e kalimit në kontroll (Hosting dhe Domain) të Institucionit.

Drejtuar: Administratorit të Universitetit

Znj. Mirela Duka

Për Dijeni: Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë,

Prof. Dr. Roland Zisi

Faqja zyrtare është hapur për herë të parë në mënyrë funksionale nga Ervin Ruci (Spec. IT) dhe Rezart Muço (Spec. IT) gjatë vitit 2009, në kohën që universiteti drejtohej nga Prof. Dr. Tanush Shaska. Kjo faqe është hostuar në "lunarpages.com" domethënë domain i huaj që paguhej nga ana e IT me kartë krediti dhe më pas universiteti gjente mënyrën për ta rimbursuar.

Në vitin 2010 kjo faqe u mbyll për disa kohë dhe u rihap sërish me një faqe që fillimisht është dizenuar nga një kompani webdizanj në Tiranë dhe ka vazhduar të hostohet sërish nga "lunarpages.com". Më pas faqja ridizenjohet nga Altin Mahilaj (Spec. IT) dhe Arjan Bilo (Spec. IT) duke vendosur një template, "Ndërfaqe" të re.

Vlen të theksohet fakti se në vazhdim nderfaqja është ndryshuar edhe dy herë të tjera nga Fjodor Ziu (Laborant) i cili e ka rinovuar por gjatë kësaj kohe që i bie afërsisht 3 vite nga momenti i tanishëm hostimi i faqes bëhet subjekt tenderi dhe tenderohet ku fitues del Kompania Fastech nga Tirana me web: www.fastech.com.al/ e cila e ka fituar tenderin edhe për 2 vitet e tjera në vazhdim që përfundon diku në gusht të 2017 të këtij viti.

Tenderi është në vlerën e 500.000 mijë lekë të reja në vit. Kjo kompani nga ana e saj hostimin e faqes univlora.edu.al ja ka lënë për detyrë një nënkontraktuesi të tretë konkretisht abcom.al e cila përdor servera që fizikisht ndodhen në Tiranë. Momentalisht edhe një ndërfaqe tjetër është e gatshme por që nuk është vënë në punë dhe mbahet në rezervë që të përdoret në një moment të përshtatshëm dhe e disponon IT.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

Pra WEB-i i UV-së nuk kontrollohet nga IT e institucionit por nga kompani dhe specialistë jashtë institucionit. Që faqja elektronike të merret në kontroll nga vet institucioni duhet të sigurohen paraprakisht infrastruktura e nevojshme teknike.

Pengesë për marrjen në kontroll të webfaqes univlora.edu.al dhe hostimin e saj nga vet IT bëhet mungesa e infrastrukturës për këtë qëllim.

Me fjalë të tjera për të tejkaluar këtë pengesë ka dy mënyra:

Varianti A: Duhet blerë server dhe pajisjet ndihmëse të tyre (aksesor) të cilët fizikisht duhet të ndodhen në ambientet e Universitetit "Ismail Qemali".

Për të arritur këtë qëllim propozohen të bëhen blerje fizike si më poshtë:

Nr.	Produkti	Sasia	Çmimi/Euro	Vlera/Euro
1	Server Web-i	1	7000	7000
2	Inverter > 3.5 KW	1	2000	2000
3	Bateri 100Ah (Gel)	4	200	800
4	UPS > 3.5 KW	1	3000	3000
5	Software + Certifikata Sigurie	1	1000	1000
Totali			13800	

Këto pajisje do të qëndrojnë në një ambient të përshtatshëm brenda Universitetit tonë ku do të mirëmbahen dhe përditësohen nga punonjësit e IT të cilët do të kenë edhe detyrën dhe përgjegjësinë e ruajtjes.

Me blerjen e këtyre pajisjeve bëhet e mundur që webfaqja jonë të kaloj plotësisht në kontrollin e IT dhe të përdoret gjerësisht edhe për nevoja të tjera të Universitetit tonë. Theksojmë se vlera e përfaqësuar, sipas ofertave të tregut, e Serverit dhe aksesoreve të tjerë që mundësojnë pavarësimin e plotë dhe kontrollin tërësor institucional mbi WEB-in e UV-së, nuk e kalon shifrën 14 mijë euro.

Varianti B: Marrje me qira hardware për hostim faqe web

Për të arritur këtë qëllim propozohen të bëhen blerje online si më poshtë:

Nr.	Produkti	Sasia	Çmimi/Euro	Vlera/Euro
1	Server Web-i Versioni Cloud	1		
2	Software + Certifikata Sigurie	1		
Totali			1000 Euro në vit	

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

Këto pajisje nuk do të qëndrojnë brenda Universitetit tonë por webfaqja do të mirëmbahet dhe përditësohet nga punonjësit e IT.

Për të realizuar variantin B duhet që universitetit fillimisht të hapi një kartë krediti për blerje dhe pagesa online me numër institucional të llogarisë bankare. Nëse realizohet ky kusht atëherë mund të kryen veprimet e mësipërme për këtë variant.

Për të paraqitur avantazhet dhe dizavantazhet e secilit variant është bërë një analizë krahasuese në tabelën e mëposhtme:

Varianti A	Varianti B
Blerje hardware për instalim Serveri në ambientet e Univeristetit, për hostimin e faqes	Marrje me qira server për hostimin e faqes
Procedura e hostimit e shpejtë dhe e menjëhershme	Procedura e blerjes së hostimit burokratike dhe e ngadaltë (Prokurim direkt i pamundur)
Kosto e madhe blerje fillestare	Kosto shumë e ulët
Kosto në burime njerëzore për mirëmbajtjen	Kosto e ulët mirëmbajtje
Kosto interneti e lartë, pasi kërkon 2 linja nga 2 ISP te ndryshme të pavarura nga njëra-tjetra.	Kosto = 0
Kosto konsumi hardware, jetëgjatësia e rekomanduar 4 vjet.	Kosto = 0
Shërbimi Uptime online 70%, kjo për shkak të shërbimit internet dhe ndërprerjes së energjisë në Shqipëri	Uptime online 99%
Informacionet ruhen në ambientet e Universitetit	Informacionet ruhen në server online, dhe mund të ruhen në ambientet e Universitetit me anë të backup periodik, ditor, javor etj.
Siguria e Shumë e Lartë	Siguria e Shumë e Lartë
Mund të përdoret shumë edhe për qëllime dhe projekte te tjera	Nuk mund të përdoret dot shumë edhe për qëllime dhe projekte te tjera

Nëse bëhet njëri prej këtyre investimeve themelore atëherë do të kemi një situatë tjetër me disa përfitime dhe avantazhe, si më poshtë:

1. Nuk do të kemi shpërndarje dhe rrjedhje të informacioneve sensitive, të dhëna personale, nga brenda serverit tek palë të treta.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
STATISTIKAVE

2. UV nuk do të prokurojë çdo vit shërbimin për WEB-in që kushton 500.000 mijë lekë të reja.
3. UV nuk do të jetë i varur dhe i ndërvarur nga kompani kontraktore dhe nënkontraktore.
4. Investimi i kryer një herë të vetme mbetet në pronësi të UV-së.
5. Realizohet kontrolli i plotë dhe i drejtpërdrejtë i WEB-it nga institucioni.
6. Realizohet shërbim i menjëhershëm dhe jo i porositur dhe i pritur.
7. Kryhet në çdo rast e kohë, transparencë në shërbim dhe kërkesë e sigurt llogarie.
8. WEB-i i UV-së kthehet në një strukturë multimediale në shërbim dhe pronësi të plotë të institucionit.

Konkluzion: Duke pasur parasysh avantazhet dhe dizavantazhet e secilit variant gjykojmë që të aplikohet Varianti B si më i përshtatshëm ekonomikisht që përmbush pritshmëritë tona dhe në rast pamundësie atëherë të aplikohet Varianti A.

Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave

Medrit MUSTAFARAJ, (Drejtor)